

Komisioni i Disiplinës
VENDIM
Nr. 3

27 Maj 2024

Më datë 27 maj 2024 u mbledh Komisioni i Disiplinës i Federatës Shqiptare të Basketbollit, nën drejtimin e kryetarit, z. Klevis Kaso, me praninë e anëtarëve, z. Franko Bushati dhe z. Klaudio Ndoja, për trajtimin e problematikës të hasur pas ndeshjes KB Teuta - Partizani, ½ finale e kampionatit kombëtar U16 djem, data 25.05.2024, pallati i sportit "Ramazan Njala", Durrës. Në relacionin e gjyqtarëve të ndeshjes paraqitet situatë e tensionuar pas përfundimit të ndeshjes, nisur nga lojtari me numrin 34, Aaron Qyrfyçja, pjesë e ekipit KB Teuta, si dhe përshkallëzim i situatës nga hyrja e spektatorëve në fushë.

Për sa mësipër, Komisioni i Disiplinës pasi trajtoi materialet përkatëse për shqyrtim, duke marrë në konsideratë relacionin e gjyqtarëve bazuar në nenin 16.15, të rregullores së aktiviteteve kombëtare të basketbollit, "Në rast se në ndeshje nuk është caktuar ndonjë vëzhgues, këtë detyrë e kryen gjyqtari i parë",
Vendosi:

1. Sanksion financiar në vlerën 10'000 lek për lojtarin, Aaron Qyrfyçja, bazuar në rregulloren e aktiviteteve kombëtare të basketbollit, neni 14.9, "*Sjellje josportive e lojtarëve, trajnerëve apo personave të tjerë që qëndrojnë në stol (fyerje, kërcënime, etj) të cilat nuk janë ndëshkuar nga gjyqtaret gjatë ndeshjes si edhe pas përfundimit të saj, por paraqiten nga vëzhguesi*".
2. Sanksion financiar në vlerën 10'000 lek për shoqatën KB Teuta, si ekip organizator i ndeshjes, bazuar në rregulloren e aktiviteteve kombëtare të basketbollit, neni 13.8.f, "*Hyrja e spektatorëve në fushën e lojës para, gjatë ose pas ndeshjes (pa u larguar ekipet dhe gjyqtarët), në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare*".

Në bazë të rregullores së aktiviteteve kombëtare të basketbollit, neni 11.8, kundër vendimeve të mësipërme mund të apelohe brenda 72 orëve nga marrja e vendimit.



Klevis Kaso
Kryetar



Franko Bushati
Anëtar



Klaudio Ndoja
Anëtar